



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI**

---

Numri i lëndës: 2020:086748

Datë: 31.05.2022

Numri i dokumentit: 03076817

CP.nr. 1/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Kaltrina Sfarqa, në çështjen përmbare të kreditores D.Gj. kundër debitorit Spitalit “Sh. Z.”, në V. lidhur me pagesën e pagave për shpërblim jubilar, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr. 426/2020 të datës 19.10.2020, i plotfuqishëm nga data 09.11.2020 dhe Aktvendim të kësaj Gjykate CP.nr 1/2021, të datës 15.03.2021 dhe Aktvendimit përmirësues CP.nr. 01/2021, të datës 18.01.2022 jashtë seancës, me datën 31.05.2022 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

PËRFUNDOHET procedura përmbare e kreditores D. Gj. ndaj debitorit Spitali “Sh.Z.”, në Vushtri, për detyrimin në emër të pagesës së pagave për shpërblimin jubilar, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr. 426/2020 të datës 19.10.2020, i cili ka marrë formën e prerë me datë 09.11.2020, për shkak të përmbushjes së tërësishme të detyrimit.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin CP.nr.1/2021 të datës 14.01.2021, ka lejuar propozimin për përmbare të kreditorit të përmbaremit D. Gj. kundër debitorit Spitali “Sh. Z.”, në V. për përmbaremin e dokumentit përmbaremit Aktgjykimit të plotfuqishëm C.nr. 426/2020 të datës 19.10.2020 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, për shkak të detyrimit në të holla në

emër të pagesës së pagave për shpërblim jubilar dhe atë në shumën prej 1.470,84 € ( njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë euro e tetëdhjetë e katër cent).

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se pas lejimit të përmbarimit, debitori e ka paguar në tërësi detyrimin ndaj kreditorit, sipas njoftimit nga përfaqësuesi i autorizuar i kreditores, av. Kada Bunjaku - Përçuku.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar në tërësi detyrimin që kishte ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, gjykata e përfundoi procedurën e përmbarimit si rrjedhojë e përmbushjes në tërësi të kredisë në të holla të palës kreditore.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat dhe në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm për Çështje Civile

CP.nr.1/2021, datë 31.05.2022

Gj y q t a r i  
Naim Rekaliu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.